REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA MALIQ
KRYETARI I BASHKISË

Nr.2825 Prot. Maliq, më 23.05.2025

PROJEKT -VENDIM

Nr. 5 ,datë 23.05.2025

"Për një ndryshim në buxhetin e vitit 2025"

Në mbështetje të Ligjit nr.139/2015 "*Për vetëqeverisjen vendore*" neni 54 "*Detyrat dhe kompetencat e këshillit bashkiak*" gërma (dh), ligjit 9936 datë 26.6.2008 "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë" neni 32 , "Përgatitja dhe miratimi i buxheteve vendore", ligjit nr.68/2018 "Për financat e vetëqeverisjes vendore" ,Vendimit të Këshillit të Bashkisë nr.130 dtatë 26.12.2024 "Për miratimin e buxhetit për vitin 2025", shkresë së Drejtorisë të Pronave Publike dhe Aseteve nr.82. prot,datë 28.03.2025 "Kërkesë për bashkëpunim" i kërkoj Këshillit të Bashkisë :

1. Ndryshim në buxhetin e vitit 2025 si më poshtë vijon :

Pakësim *në 000/lekë*

Gr.	Kap.	Kod. Prog.	Llog.Ek.	Kodi Objekti	Objekti	
00	05	04520	2313100	1680328	*'Tapet rrugë viti 2024'*	**4,368**
00	05	04520	2313100	1680347	*'Sistemim asfaltim rrugë Maliq'*	**543**

Shtesë

Gr.	Kap.	Kod, Prog.	Llog.Ek.	Kodi Objekti	Objekti	
00	05	01110	6027300	9999999	'Shpenz.komp. për shpronësimet'	**4,477**
00	05	01110	2313300	1680203	'Kolaudim Ujësjellësi Mancurisht'	**434**

2. Fondi i lartëpërmendur hiqet nga zëri "Tapet rrugë viti 2024" në vlerë 4,368 dhe nga zëri '*Sistemim asfaltim rrugë Maliq'* në vlerë 543 dhe të përdoret për objektet e mëposhtme:

a)	" Shpenz.kompensimi. për shpronësimet "	*4,477*
b)	"Kolaudim Ujësjellësi Mancurisht "	*434*
	Shuma	**4,911 mijë lekë**

3. Për zbatimin e vendimit ngarkohet Drejtoria e Financës dhe Buxhetit në bashki.
4. Ky vendim hyn në fuqi pas miratimit nga Prefekti i Qarkut Korçë .

REPUBLIKA E SHQIPËRISË BASHKIA MALIQ

KRYETARI I BASHKISË

GËZIM TOPÇIU

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA MALIQ

Drejtoria e Financës dhe Buxhetit

Nr.2825 Prot. Maliq, më 20.5.2025

RELACION

"Për një ndryshim në buxhetin e vitit 2025 të Bashkisë Maliq"

KËSHILLIT TË BASHKISË

Propozimi që po ju sjellim ka të bëjë me kalimin e fondeve të kursyera nga prokurimet publike në objekte të parashikuar në Buxhetin e vitit 2025 per sa vijon :

a) *"Tapet rrugë viti 2024"* **4,368** mijë lekë
b) *'Sistemim asfaltim rrugë Maliq'* **543** mijë lekë

Fondet e lartëpërmendura do të përdoren për :

- *'Shpenz.komp. për shpronësimet'* - Pagesa për efekt të shpronësimit të tokave bujqësore që do të *përdoren për zgjerimin e varrezave në disa fshatra.*
- *'Kolaudim Ujësjellësi Mancurisht'* - Fondi është i nevojshëm për kolaudimin e objektit .

Bashkëngjitur po ju dërgojmë dokumentacionin e Drejtorisë të Pronave Pubike dhe Aseteve për këtë qëllim.

Faleminderit

Konceptoi : **Almira Muka**

KRYETARI I BASHKISË

GËZIM TOPÇIU

REPUBLIKA E SHQIPËRISË BASHKIA MALIQ

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA MALIQ

GRUPI I PUNËS

Nr. 144, datë 06.03.2025

Prot. 2829

Maliq, më 20.03.2025

PROCES-VERBAL

"Për vlerësimin paraprak dhe përllogaritjen e masës së shpërblimit, për pasuritë private që shpronësohen nga projekti "Zgjerimi i varrezave publike në fshatrat Podgorie, Sovjan, Pojan, Zëmblak dhe Vloçisht të Bashkisë Maliq"

Në zbatim të Ligjit Nr. 139/2015 "*Për Vetëqeverisjen Vendore*" i ndryshuar, Ligjit Nr. 8561, datë 22.12.1999 "*Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë pronë private, për interes publik*" i ndryshuar, VKM Nr. 138, datë 23.03.2000 "*Për kriteret teknike të vlerësimit dhe përllogaritjes së masës së shpërblimit të pasurive pronë private që shpronësohen, të pasurive që zhvlerësohen dhe të të drejtave të personave të tretë, për interes publik*" i ndryshuar, VKM Nr. 89 datë 03.02.2016 "*Për miratimin e hartës së vlerës së tokës në Republikën e Shqipërisë*", Vendimit të Këshillit të Bashkisë Maliq nr. 112, datë 31.10.2024 "*Për fillimin e procedurave të shpronësimit për interes publik të pasurive private që preken nga zbatimi i projektit "Zgjerimi i varrezave publike në fshatrat Podgorie, Sovjan, Pojan, Zëmblak dhe Vloçisht të Bashkisë Maliq*", si dhe bazuar në Urdhërin Nr. 144, datë 06.03.2025 të Kryetarit të Bashkisë Maliq "*Për ngritjen e grupit të punës për vlerësimin paraprak të masës së shpërblimit, për shpronësimin e pasurive private që preken nga zbatimi i projektit "Zgjerimi i varrezave publike në fshatrat Podgorie, Sovjan, Pojan, Zëmblak dhe Vloçisht të Bashkisë Maliq*", grupi i punës ka marrë në shqyrtim dhe ka konkluduar për sa më poshtë:

Referuar proces-verbalit të datës 24.09.2024 nga grupi i punës të përcaktuar në Urdhrin e Kryetarit të Bashkisë nr. 464, datë 20.09.2024, me anë të secilit janë përcaktuar pronat private që preken, pronaret e tyre dhe sipërfaqet perkatëse për secilën pasuri, si dhe kartelave të pasurisë të marrë zyrtarisht nga Agjencia Shtetërore e Kadastrës nëpërmjet shkresës nr. 5288/1 prot., datë 06.03.2025, po parashtrojmë tabelën me përllogaritjet si më poshtë, referuar bazës ligjore të sipërcituar, për llojet e pasurisë arë (*VKM Nr. 89 datë 03.02.2016 "Për miratimin e hartës së vlerës së tokës në Republikën e Shqipërisë"*):

Lista emërore që preken nga zbatimi i projektit *"Zgjerimi i varrezave publike në fshatrat Podgorie, Sovjan, Pojan, Zëmblak dhe Vloçisht të Bashkisë Maliq"*, prona private:

Nr.	Emër Mbiemër (Pronari)	Nr. Pasurisë	Zona Kadastrale	Lloji i pasurisë	Sipërfaqja që preket (m^2)	Çmimi referencë (lekë/m^2)	Vlera e pasurisë që shpronësohet (lekë)
1	Esat Bedri Hadri	99/6	3010	Arë	2083	100	208,300
2	Tahir Hysen Bezati	99/7	3010	Arë	2074	100	207,400
3	Hysen Tahir Bezati	99/8	3010	Arë	2501	100	250,100
4	Nesti Dhori Kozmanllari	1635/1	3496	Arë	2475	100	247,500
5	Niko Dhori Kozmanllari	1635/2	3496	Arë	3204	100	320,400
6	Jovan Nuni Kozmanllari	1635/3	3496	Arë	3286	100	328,600
7	Hiqmet Emin Mullalli	141/3	3903	Arë	1685	100	168,500
8	Erion Ditron Mullalli	141/4	3903	Arë	577	100	57,700
9	Osman Xhezar Mullalli	141/5	3903	Arë	660	100	66,000
10	Shkëlzen Hibraim Mullalli	141/6	3903	Arë	1690	100	169,000
11	Nefail Rushan Mullalli	141/7	3903	Arë	1079	100	107,900
12	Hekuran Xhezar Mullalli	141/8	3903	Arë	1241	100	124,100
13	Xhevahir Dalip Xhihani	92/29	3014	Arë	1357	248	336,536
14	Xhelal Sali Xhihani	92/30	3014	Arë	1856	248	460,288
15	Suat Myrteza Xhihani	92/31	3014	Arë	2025	248	502,200
16	Bashkim Qamil Lime	132/12	3803	Arë	4385	170	745,450
17	Bashkim Qamil Lime	132/13	3803	Arë	1040	170	176,800
							4,476,774

TOTALI = 4,476,774 (*katër milion e katërqind e shtatëdhjetë e gjashtë mijë e shtatëqind e shtatëdhjetë e katër*) lekë.

Grupi i punës:

1-Nertil Çaushi

2-Fjoralda Demollari

3-Arben Dulellari

MIRATOHET
KRYETARI I BASHKISË
Gëzim Topçiu